



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

R R E G U L L O R E

për

Regjistrimin e pajtimtarëve dhe mbajtjen e të dhënave

(Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. ____, datë ____. ____. 2010)

TIRANË 2010

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është plotësimi i kuadrit ligjor me aktet e nevojshme administrative lidhur me regjistrimin e pajtimtarëve nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe mbajtjen e të dhënave të caktuara, në përputhje me ligjin nr. 9918, datë 19. 05. 2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*) dhe të harmonizuara me Direktivën 2006/24/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit, dt.15 Mars 2006, “Për mbajtjen e të dhënave të krijuara ose të përpunuara në lidhje me ofrimin ose vënien në dispozicion të shërbimeve të komunikimeve elektronike ose të rrjeteve të komunikimeve publike duke ndryshuar Direktivën 2002/58/EC” (**Direktiva**).

Neni 2 Fusha e zbatimit

- 2.1 Kjo rregullore zbatohet nga të gjithë sipërmarrësit që kanë njoftuar në AKEP sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm, ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, për regjistrimin e pajtimtarëve të tyre përpara aktivizimit të shërbimit, si dhe për mbajtjen e të dhënave të përcaktuara në këtë rregullore, nëse të dhënat krijohen ose përpunohen prej tyre në Republikën e Shqipërisë.
- 2.2 Kjo rregullore nuk do të zbatohet për përmbajtjen (kontentin) e komunikimeve elektronike.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- 3.1 “*Të dhëna*” do të thotë të dhënat e trafikut dhe të dhënat e vendndodhjes, të nevojshme për identifikimin e pajtimtarit ose përdoruesit;
- 3.2 “*Pajtimtar*” nënkupton çdo person juridik, person fizik ose natyror, i cili për përdorimin e rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të ofruara nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ka lidhur me ta (sipërmarrësit) kontratë pajtimi ose është regjistruar për blerjen e këtyre shërbimeve, me kartë të parapaguar;
- 3.3 “*Shërbim telefonik*” do të thotë thirrje (përfshirë zërin, mesazhin zanor, thirrjet konferenca, dhe “data call”), shërbimet suplementare (përfshirë “call forwarding” dhe “call transfer”), mesazhe dhe shërbime multi-media (përfshirë shërbimet SMS, shërbimet media dhe multi-media);
- 3.4 “*ID e pajtimtarit*” do të thotë një identifikues unik i dhënë personit (pajtimtarit) kur regjistrohet ose për tu regjistruar, në një shërbim hyrje (akses) internet ose shërbime të komunikimeve me internet;
- 3.5 “*Qelizë ID*” do të thotë identiteti i qelizës nga e cila mund të iniciohet ose mund të

- përfundojë një bisedë në celular;
- 3.6 “Thirrje e pasuksesshme” nënkupton një përpjekje për komunikim ku një thirrje telefonike ka qenë e lidhur me sukses, por nuk është përgjigjur ose nuk ka pasur një ndërhyrje të administratorit të rrjetit.

Neni 4

Detyrimi për regjistrimin e pajtimtarëve

- 4.1 Për identifikimin e pajtimtarëve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të regjistruar në AKEP për ushtrimin e veprimtarisë sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm, detyrohen të bëjnë regjistrimin e identitetit të plotë të pajtimtarëve të tyre, përpara aktivizimit të shërbimit.
- 4.2 Regjistrimi i pajtimtarëve kryhet nga sipërmarrësit e mësipërcituar sipas të dhënave të përcaktuara nga AKEP në formularët përkatës, bashkëlidhur kësaj rregulloreje në Aneksin 1 “Formularët e Regjistrimit të Pajtimtarëve”, njëkohësisht me nënshkrim e kontratës së pajtimit.
- 4.3 Pajtimtarët i japin sipërmarrësve, me të cilët kanë lidhur një kontratë pajtimi, të dhënat e tyre, të përcaktuara në formularët e miratuar nga AKEP, bashkëlidhur kësaj rregulloreje në Aneksin 1 “Formularët e Regjistrimit të Pajtimtarëve”.

Neni 5

Detyrimi për mbajtjen e të dhënave

- 5.1 Sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike detyrohen të mbajnë të dhënat e pajtimtarëve dhe t’i ruajnë ato në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.
- 5.2 Për thirrjet e pasuksesshme sipërmarrësit nuk përjashtohen nga detyrimi për mbajtjen e të dhënave. Nga ky detyrim sipërmarrësit përjashtohen vetëm për thirrjet e palidhura.

Neni 6

Afati ruajtjes së të dhënave

Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike detyrohen të ruajnë të dhënat e mbajtura për pajtimtarët, të përcaktuara në këtë rregullore, për një afat dy (2) vjeçar nga data e komunikimit.

Neni 7

Të dhënat që do të mbahen

- 7.1 Sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike janë të detyruar të mbajnë për pajtimtarët skedarët me të dhënat e poshtëshënuara që mundësojnë:
- (a) identifikimin e pajtimtarëve, duke siguruar marrjen dhe regjistrimin e identitetit të plotë të tyre;
 - (b) identifikimin e pajisjes fundore, të përdorur gjatë komunikimeve;
 - (c) përcaktimin e datës, të orës, kohëzgjatjes së komunikimit dhe numrit të thirrur.
- 7.2 Të dhënat e nevojshme për të gjetur dhe identifikuar burimin e një komunikimi janë:
- (a) Lidhur me rrjetin e telefonisë fikse dhe celulare:
 - (i) *numri i telefonit thirrës;*
 - (ii) *emrin dhe adresën e pajtimtarit të regjistruar.*
 - (b) Lidhur me aksesin në internet, e-mail në internet dhe telefoni në internet:
 - (i) *ID e dhënë pajtimtarit;*
 - (ii) *ID e dhënë pajtimtarit dhe numrin e caktuar të telefonit për çdo komunikim që hyn në rrjetin e telefonisë publike;*
 - (iii) *emrin dhe adresën e pajtimtarit apo përdoruesit të regjistruar i cili disponon (i është dhënë) në momentin e komunikimit një adresë Internet Protocol (IP), ID përdoruesi ose numur telefoni.*
- 7.3 Të dhënat e nevojshme për identifikimin e destinacionit të një komunikimi janë:
- (a) Lidhur me rrjetin e telefonisë fikse dhe celulare:
 - (i) *numri (at) e telefonit (ve) të kërkuar, dhe, në rastet e përfshirjes së shërbimeve shitesë si “call forwarding” apo “call transfer”, çdo numuri telefonik tek i cili thirrja është dërguar apo transferuar;*
 - (ii) *emrin (at) dhe adresa (t) e pajtimtarit (ve).*
 - (b) Lidhur me aksesin në internet, e-mail në internet dhe telefoni në internet:
 - (i) *ID e pajtimtarit ose numrin e telefonit të destinuar marrësit (ve) të një thirrje telefoni në internet;*
 - (ii) *emrin (at) dhe adresën (at) e pajtimtarit dhe ID e pajtimtarit marrës.*
- 7.4 Të dhënat e nevojshme për të identifikuar datën, kohën dhe kohëzgjatjen e komunikimit janë:
- (a) Lidhur me rrjetin e telefonisë fikse dhe të lëvizshme:
 - (i) *datën dhe kohën e fillimit dhe përfundimit të komunikimit.*
 - (b) Lidhur me aksesin në internet, e-mail në internet dhe telefoni në internet:
 - (i) *datën dhe kohën e log-in dhe log-off të aksesit në shërbimin e internetit, të bazuar në një zonë të caktuar kohe, së bashku me adresën IP, dinamike ose statike, të*

- caktuara nga ofruesi i shërbimit të internetit në një komunikim, dhe ID e pajtimtarit.*
- (ii) *datën dhe orën e log-in dhe log-off të shërbimit të e-mail në internetit apo telefoni në internet, bazuar në një zonë të caktuar kohe.*
- 7.5 Të dhënat e nevojshme për të identifikuar llojin e komunikimit janë:
- (a) Lidhur me rrjetin e telefonisë fikse dhe të lëvizshme:
- (i) *Shërbimin telefonik të përdorur.*
- (b) Lidhur me aksesin në internet, e-mail në internet dhe telefoni në internet:
- (i) *Shërbimet e internetit të përdorura.*
- 7.6 Të dhënat e nevojshme për të identifikuar pajisjet e komunikimit të pajtimtarëve janë:
- (a) Lidhur me rrjetin e telefonisë fikse:
- (i) *numrat e thirrur dhe thirrës telefonik.*
- (b) Lidhur me rrjetin e telefonisë së lëvizshme:
- (i) *numrat e telefonit që thërret dhe të thërrasin;*
- (ii) *International Mobile Subscriber Identity (IMSI) e atij që merr;*
- (iii) *International Mobile Equipment Identity (IMEI) e atij që merr;*
- (iv) *IMSI e atij që pret thirrjen;*
- (v) *IMEI e atij që pret thirrjen;*
- (vi) *në rastin e shërbimeve anonime të parapaguara, datën dhe kohën e aktivizimit të parë të shërbimit dhe ID e qelizës nga të cilat shërbimi u aktivizua.*
- (c) Lidhur me aksesin në internet, e-mail në internet dhe telefoni në internet:
- (i) *numrin e telefonit që ka bërë thirrje për dial-up akses;*
- (ii) *parapaguesi i linjës dixhitale (DSL) dhe pikë tjetër fundore e origjinimit të thirrjes.*
- 7.7 Të dhënat e nevojshme për të identifikuar vendndodhjen e pajisjeve të telefonisë së lëvizshme janë:
- (i) *ID të qelizës në fillim të komunikimit;*
- (ii) *të dhënat që identifikojnë vendndodhjen gjeografike të qelizave sipas ID të qelizës.*

Neni 8

Mbrojtja dhe siguria e të dhënave

- 8.1 Për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave të mbajtura dhe në ruajtje sipas kësaj rregulloreje, sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike duhet të zbatojnë minimalisht parimet vijuese të sigurisë:

- (a) të dhënat, të kenë të njejtin kualitet dhe të jenë subjekt i së njejtës siguri dhe mbrojtje, si ato të dhëna për rrjetin;
 - (b) të dhënat duhet të jenë subjekt i masave të përshtatshme organizative dhe teknike për ti mbrojtur nga shkatërrimi i paligjshëm ose aksidental, humbjet aksidentale ose ndryshimi, magazinimi i paligjshëm, përpunimi, aksesimi apo zbulimi (hapja) i tyre;
 - (c) të dhënat duhet të jenë subjekt i masave të përshtatshme organizative e teknike për të siguruar që ato mund të arrihen vetëm nga personeli i autorizuar dhe i specializuar;
 - (d) të dhënat, përveç atyre që janë kërkuar (aksesuar) nga organet kompetente të hetimit, zbulimit dhe ndjekjes penale, shkatërrohen në fund të periudhës dy (2) vjeçare të ruajtjes.
- 8.2 Shkatërrimi (fshirja) e të dhënave në fund të periudhës së ruajtjes kryhet nga mbajtësit e tyre (sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike) në mënyrë që të sigurohet asgjësimi dhe pamundësia e aksesimit në to nga cilado palë.
- 8.3 Për shkatërrimin e të dhënave sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike organizojnë punën për të realizuar fshirjen e tyre në mënyrë sistematike dhe progresive duke filluar nga data më e hershme e regjistrimit dhe mbajtjes. Shkatërrimi i të dhënave pas përfundimit të afatit të ruajtjes nuk duhet të zgjasë më tepër se 30 ditë nga data e përfundimit të këtij afati.

Neni 9

Vënia në dispozicion e të dhënave

- 9.1 Skedarët me të dhënat e mbajtura nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike sipas kësaj rregulloreje duhet t'u vihen në dispozicion mbi bazën e një kërkesë zyrtare me shkrim, autoriteteve kompetente të autorizuar ligjërisht për të patur akses në këto të dhëna, për qëllime të hetimit, zbulimit dhe ndjekjes penale.
- 9.2 Skedarët me të dhënat e mbajtura duhet t'u vihen në dispozicion autoriteteve kompetente të mësipërcituara nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, edhe në mënyrë elektronike.

Neni 10

Magazinimi i të dhënave

Të dhënat e mbajtura në zbatim të kësaj rregulloreje duhet të magazinohen nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, në mënyrë të tillë që të mund të transmetohen pa vonesë kur paraqitet kërkesë për to.

Neni 11

Te dhënat e mbajtura nga nje ofrues tjetër i komunikimeve publike

12. (1) Me përjashtim të rastit kur është njoftuar me shkrim nga AKEP, kjo Rregullore nuk është e detyrueshme për një ofrues të komunikimeve publike, nëse të dhënat e komunikimit në fjalë mbahen në Shqipëri, në përputhje me këtë Rregullore, nga një ofrues tjetër i komunikimeve publike.

(2) Çdo njoftim i tillë duhet të specifikojë:

(a) ofruesin e komunikimeve publike, ose kategorinë e ofruesve të komunikimeve publike, të cilëve u është drejtuar, dhe

(b) deri në ç' masë dhe nga cila datë do të zbatohen dispozitat e kësaj rregulloreje.

(3) Njoftimi duhet të jepet ose të publikohet në mënyrën që konsiderohet e përshtatshme për të qenë në vëmendje të ofruesit të komunikimeve publike, ose kategorisë të ofruesve, të cilëve u takon.

Neni 12

Dhënia e informacionit statistikor

11.1 Çdo sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet të dërgojë tek AKEP, sa më shpejt të jetë e mundur pas datës 31 Mars të çdo viti, por jo më vonë se data 31 Maj, informacionin vijues statistikor lidhur me vitin kalendarik paraardhës.

11.2 Informacioni statistikor i kërkuar përmban :

a) numrin e rasteve kur të dhënat e mbajtura në përputhje me këtë rregullore janë zbuluar (vënë në dispozicion) autoriteteve kompetente në përgjigje të një kërkesë;

b) numrin e rasteve kur një kërkesë për zbulimin e ligjshëm të të dhënave të mbajtura në përputhje me këtë rregullore nuk ka qenë e mundur të plotësohet.

11.3. AKEP mund të ndryshojë datën e specifikuar në paragrafin e mësipërm (11.1) duke njoftuar me shkrim sipërmarrësin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.

Neni 13

Sanksionet

12.1 Moszbatimi nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike i rregullave dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore në rastet kur nuk përbën vepër penale, përbëjnë kundravajtje administrative dhe është i dënueshëm në përputhje me përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 135 dhe pikën VII të nenit 137 të ligjit nr. 9918.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Rregullorja hyn në fuqi datën e publikimit në faqen elektronike të AKEP www.akep.al, pas miratimit të saj nga Këshilli Drejtues i AKEP.

